

## Këshilla për prindër të fëmijëve dhe të rinjve

### Parathënie

Prindër të dashur

Edukimi është një sfidë emocionuese, tek i cili Ju bartni përgjegjësinë kryesore për mirëqenien e fëmijëve Tuaj. Ne shpresojmë që ne me këto këshilla do ju japim impulse të dobishme. Pasi që edukimi Juaj e forcon fëmijën Tuaj, nëse Ju...

- atij i dhuroni dashuri,
- diskutoni me atë dhe bile edhe grinduni,
- e dëgjoni atë,
- i caktoni kufijtë dhe i jepni hapësirë të lirë,
- atij i shprehni ndjenjat Tuaja,
- i dedikoni atij më tepër kohë,
- i jepni guxim dhe
- nuk i leni marrje vendimesh në dorë, të cilat ai nuk i zotëron.

Kështu ne Juve gjatë edukimit të fëmijës Tuaj ju urojmë shumë guxim dhe kënaqësi, si dhe përjetime të përbashkëta pozitive.

Komisioni për rini Sins

### Prindërit si shembull

Si prindër Ju jeni shembull përfundim i fëmijëve Tuaj dhe bartni përgjegjësinë kryesore për zhvillimin e fëmijës Tuaj. Përveç nga prindërit fëmija përfjeton edhe ndikime tjera – në shkollë, me shokët, në shoqëri, me vëllezër dhe motra etj. Përveç kësaj ai ka edhe karakterin e vet dhe të drejtën për qenë individ në vete.

Përveç një banimi të sigurt, me plot përkujdes dhe rregullave gjegjëse ndaj moshës së tij, fëmija Juaj ka nevojë edhe përkujdesin dhe interesimin Tuaj ndaj veprimeve të tij, përfundimisht e tij pozitiv. Tentoni që përfundimisht po ashtu edhe adoleshentin, të jeni një partner i dashur diskutimi, mirëpo njëkohësisht edhe partner kritik dhe i besueshëm.

Si i ri/e re, fëmija Juaj gjendet në fazën e shkëputjes nga Ju si prindër dhe gjendet në kërkim të identitetit të vet. Në këtë fazë fëmija Juaj ka nevojë përfundimisht edhe mbështetje, mirëpo edhe përfundimisht rregulla të qarta. Mu tanë kërkohet funksioni Juaj si shembull prindërorë dhe kjo paraqet një sfidë të veçantë.

Ju, në rolin e shembullit, mund ta mbështesni fëmijën Tuaj në zhvillimin e tij:

- Bëni biseda të hapura, konstruktive me fëmijën Tuaj.
- Në raste të konflikteve kërkonи zgjidhjen bashkërisht me fëmijën Tuaj.
- Vini re për atë, që në bisedat familjare të dëgjohet secili mendim, edhe ai i fëmijëve të vegjël.
- Përgëzoni mendimet e ndryshme. Ato hapin perspektiva të reja përfundimisht e gjithë familjen.
- Bëni marrëveshje me të gjithë anëtarët e familjes përfundimisht rregulla të detyrueshme, të cilat e lehtësojnë jetën e përbashkët dhe e mbështesin mirëqenien.
- Kaloni shumë kohë me fëmijën Tuaj.
- Falni besimin fëmijës Tuaj dhe ai do ju përgjigjet me besueshmëri – tërësisht në kuptim të personit shembullor.
- Siguroni fëmijës Tuaj hapësirë të lirë, dhe njëkohësisht vendosni kufij të qartë dhe kujdesuni që këto të respektohen.
- Jetoni në tolerancë, jini të hapur ndaj religjioneve dhe kulturave tjera.

- Mos ju shmangni sjelljeve të ndryshuara dhe nëse jeni të shqetësuar, kërkonи mbështetje tek familjarët, të njojurit apo personat kompetent profesional.
- Në raste të zbatimit të dhunës mos shikoni anash! Reagoni ndaj kësaj!

[www.elternnotruf.ch](http://www.elternnotruf.ch)

[www.fritzundfraenzi.ch](http://www.fritzundfraenzi.ch)

### Para xhepi

Në Zvicër gjithnjë e më tepër të rinj janë të zhytur në borxhe. Rreth një e pesta e të rinjve të rritur tregojnë sjellje të varësisëblerëse. Për këtë arsy fëmija duhet ta mëson me kohë trajtimin e parave.

Kush ka para në dispozicion, mund të mësohet që këto ti trajton drejtë. Merruni vesh me fëmijën Tuaj, se për çfarë ta shfrytëzojnë paranë e xhepit.

- Përcaktim i sakët, se për çfarë duhet të mjaftojnë.
- Jepje e rregullt dhe pa i kërkuar (pa parapagime).
- Mos kërkonи llogari për secilin shpenzim.
- Parat e imëta mos i shfrytëzoni si mjet presioni.
- Mos ju ndalni parat e imëta si dënim për mos dëgjueshmëri.

### Rekomandimet

1. Vit shkollorë	1.00 – 2.00 CHF për javë
2. Vit shkollorë	2.00 – 3.00 CHF për javë
3. Vit shkollorë	3.00 – 4.00 CHF për javë
4. Vit shkollorë	4.00 – 5.00 CHF për javë
5. + 6. Vit shkollorë	25.00 – 30.00 CHF për muaj
7. + 8. Vit shkollorë	30.00 – 40.00 CHF për muaj
9. + 10. Vit shkollorë	40.00 – 50.00 CHF për muaj

Ekzistojnë modele të ndryshme, me të cilat fëmija Juaj mund të merr përsipër përgjegjësi vetjake me para xhepi me vlerë më të lartë. Përveç kësaj paraja xhepi mund të shtohet përmes shërbimeve të vogla pune me pagesë me parat të imëta.

[www.budgetberatung.ch](http://www.budgetberatung.ch)

[www.sackgeldjobs.ch/sins](http://www.sackgeldjobs.ch/sins)

[www.jugendlohn.ch](http://www.jugendlohn.ch)

[www.heschnocash.ch](http://www.heschnocash.ch)

### Mediat elektronike

Televizioni, PC-lojërat, konzolat e lojërave, interneti, telefoni mobil dhe stabilimentet tjera mobile sot i përkasin përditshmërisë së fëmijëve tanë. Për shfrytëzimin e mediave të ndryshme Ju duheni ti përcaktoni rregullat e sakta me fëmijën Tuaj. Ju duhet të dini, se kur fëmija Juaj dhe sa kohë kalon para ekranit dhe cilat oferta shfrytëzon.

- Përcillni fëmijën Tuaj me rast të përdorimit të mediave elektronike.
- Njoftoni fëmijën Tuaj mbi përdorimin e internetit, mbajtjen e fshehtësisë së të dhënave personale dhe mbi rrëziqet.
- Qasjen e mediave lejoni vetëm në dhomë banimi apo zyrë.
- Aktivizoni programe dhe filtra për mbrojtje fëmijësh.
- Vini re rekondimeve të moshës për secilin produkt.
- Vendosni rregulla të përbashkëta, dhe kujdesuni për përbajtje të tyre (Mbajtja e fshehtësisë së të dhënave personale, faqet e lejuara të internetit, pa shkresa ofenduese të nderit të njeriut në mediat sociale etj.).
- Kërkonи të ju tregon fëmija faqet e vizituara në internet (rast nevoje kontrollo faqet e shfletuesit).
- Vini re, që Smartphone në ditët e sotme mund të shfrytëzohet si hyrje në internet, si video lojë, si televizor apo konzolë loje.

Jo secili fëmijë duron kohën e njëjtë të qëndrimit para monitorit, dhe për këtë arsyе kohëzgjatja fikse e minutave nuk ka kuptim. Shumë me më rëndësi është, që fëmija Juaj të ketë lëvizje të bollshme, të takohet me koleget dhe kolegët, ti vë mendjen shkollimit mjaffueshëm, të merr pjesë aktive në jetën familjare, të jepet pas një pasioni, të aktivizohet në ndonjë shoqatë etj. Aktivitetet relaksuese janë çelësi i situatës.

Shenjat e varësive tregohen shpesh me mospërfilljen e faktorëve të lartë përmendur, gjegj. me interesa tepër të njëanshme. Në këto raste konsultohuni menjëherë!

[www.elternet.ch](http://www.elternet.ch)  
[www.schaugenau.ch](http://www.schaugenau.ch)  
[www.zischtig.ch](http://www.zischtig.ch)  
[www.projuventute.ch](http://www.projuventute.ch)  
[www.jugendundmedien.ch](http://www.jugendundmedien.ch)  
[www.safezone.ch](http://www.safezone.ch)  
[www.netla.ch](http://www.netla.ch)  
[www.kinder-im-internet.ch](http://www.kinder-im-internet.ch)

### **Smartphone / Telefonat mobil**

Në raste normale fëmijët deri në klasa të larta nuk kanë nevojë për një Smartphone. Smartphone fshehë rrezikun të shkakton shpenzime të larta. Nëse Ju i mundësoni fëmijës Tuaj një Smartphone vetjak, ne rekomandojmë, që fëmija Juaj të posedon një Smartphone me Prepaid-Kartele apo një abonim me kufijtë shfrytëzimi. Në këto raste vini re edhe këtyre pikave vijuese:

- Sa do të kushton kjo pajisje?
- Në çfarë mënyre shfrytëzon fëmija Juaj Smartphon-in?
- Kush i bartë shpenzimet e shkaktuar?
- Ku qëndrojnë kufijtë e shpenzimeve mujore?
- Si mundeni Ju kohë pas kohe ta kontrolloni përbajtjen, pa lënduar sferën private të fëmijës Tuaj?
- A ka fëmija qasje në internet?

Rrjetet sociale (Facebook, Instagram, Whatsapp, Snapchat, etj.) janë instrumente të rëndësishme, për ta prezantuar veten, për komunikim dhe për të qenë pjesë e një gruji bashkësedues. Rregullat e mirësjelljes (respekti, mirësjellja, nderimi, empatia etj.), të cilat vleinë në jetën reale, vleinë edhe në këto platforma. Shikoni saktësish, se si prezantohet fëmija Juaj në internet dhe se cilat informacione për vete prezanton aty. Mbështetni dhe përcjellni fëmijën Tuaj edhe në botën dixhitale! Tentoni ti ofroni fëmijës Tuaj alternativa atraktive. Ndërmerrni aktivitete të përbashkëta.

[www.schau-hin.info](http://www.schau-hin.info)

### **Ruga për në shkollë**

Ushtrimet e kalisin mjeshtri, gjithashtu edhe në trafik. Fëmijët, të cilët mësojnë me kohë të ballafaqohen me rregullat e trafikut, fitojnë në siguri. Vetura është komfore, mirëpo me shfrytëzim të gjatë ka ndikim negativ ndaj fëmijëve. Fëmijët të cilët gjatë udhës për në shkollë mund të shfryhen fizikisht, kanë aftësi më të larta fizike dhe janë më të përqendruar. Përgjatë rrugës për në shkollë fëmijët lidhe shoqëri të reja dhe ballafaqohen me konflikte. Përveç kësaj udhëtimi me taksi të prindërvë rezikon fëmijët tjerë.

Ruga për në shkollë i nënshtrohet përgjegjësisë së prindërvë. Bisedoni me fëmijën Tuaj, se cila rrugë është e sigurt deri në shkollë, ku fshehën shpërqendrimet dhe ku kanosin rreziqet. Rrugët oficiale dhe ato të rekomanduara deri në shkollë i gjeni nën [www.schulesins.ch](http://www.schulesins.ch).

Nëse fëmija Juaj shkon me bicikletë në shkollë, së pari sigurohuni, që shtigjet e bicikletave shfrytëzohen dhe se pajisjet e bicikletës i përgjigjen rregulloreve. Helmeta e b çiklisteve nuk është e obliguar, mirëpo helmeta mbron secilën kokë.

Tek E-Bikes (Biçikleta elektrike) duhet të bëhet dallimi mes të E-Bikes të ngadalshme (Ndihma e pedalimit deri në 25 km/h) dhe E-Bikes të shpejtë (Ndihma e pedalimit deri në 45 km/h). Mosha më e ulët për të E-Bikes është 14. E-Bikes të ngadalshëm mundën të drejtohen prej moshës 16 vjeçare pa leje drejtimi. Të rinxjtë me leje drejtimi të kategorisë M (Motoçikleta) guxojnë të drejtojnë E-Bikes të ngadalshëm prej moshës 14 vjeçare.

### Rrethina e mësimit

Së bashku me fëmijën Tuaj krijoni një rreth gjegjës mësimi, i cili mundëson mësim eficjent.

Gjumë i mjaftueshëm	Fëmijët deri në moshën 10 vjeçare mesatarisht kanë nevojë për 10 orë gjumë. Të rinxjtë prej 14 vjetëve kanë nevojë ende rreth 8 orë.
Lëvizje të mjaftueshme	Fëmijët në kohën e lirë duhet të lëvizin. Ngasja bicikletë, noti, loja etj. mbështesin një ndjenjë të mirë fizike dhe mprehësin e gjitha shqisat.
Ushqim i shëndetshëm	Pemë, perime, piye pa sheqer i përkasin planit ushqimorë ditorë. Një mëngjes i shëndoshë dhe një mes shujtë bile përmirësojnë fuqinë mendore.
Vend i mirë punë	Këtij i përkasin një tavolinë dhe një karrige në një vend të qetë dhe të ndritshëm, ku detyrat e shtëpisë mund të kryhen pa pengesa.
Këshilla mësimi	- Pas rreth 30 minutave planifikoni një pauzë të shkurtër. - Pirje uji, lëvizje trupore. - 30 Minuta para dhe pas mësimit pa TV apo përdorim kompjuteri, përndryshe efekti i mësimit humb!
Evitonit shpërqendrimet	Radion dhe televizorin ndalini dhe Smartphone e kyçni në modus aeroplani dhe leni larg mundësisë për kapje.

[www.lernen-mit-spass.ch](http://www.lernen-mit-spass.ch)

### Nevoja e fëmijëve dhe të rinxjve për gjumë

Mosha mesatare	Nevoja për gjumë për ditë
1-2 Vjeç	12-15 Orë
2-5 Vjeç	11-13 Orë
6-10 Vjeç	9-11 Orë
11-14 Vjeç	8-10 Orë
Prej 14 vjeçë	8 Orë

Lejoni fëmijës Tuaj gjumë të bollshëm. Vendosni kufijtë. Mungesa e gjumit tek fëmijët dhe të rinxjët mund të ndikon negativisht në suksese mësimi!

### Të ushqyerit

Përveç ajrit për frymëmarrje fëmija Juaj ka nevojë për mjete të ndryshme ushqimore, për të qenë i shëndoshë dhe i aftë për punë, të rritet dhe të zhvillohet në mënyrë optimale. Albuminat, hidratet e karbonit, yndyrat, vitaminat, mineralet, fibrat ushqyese dhe uji janë të domosdoshme për jetë. Këto nevojiten me sasi të ndryshme. Uji p.sh. lëngjet ne duhet ti konsumojmë më së shumti, përderisa vitaminat dhe mineralet, përkundër këtyre, na nevojiten me sasi minimale.

Rekomandime për ushqim dhe piye të këndshme dhe të shëndetshme mund të gjeni tek Schweizerische Gesellschaft für Ernährung SGE:

- Pini ujë (Pijet eëmbla janë gracka sheqeri!)
- Hani pemë dhe perime (5 Porcione në ditë).

- Ushqyerje e rregullt (Mëngjesi në përgjithësi vlen si shujta kryesore e ditës. Mirëpo jo të gjithë fëmijët dëshirojnë apo mundën në mëngjes të hanë pak apo sado pak. Nëse fëmijët nuk hanë mëngjes, kjo mund të zëvendësohet me një mes shujtë. Në këtë rast vlen rregulla, mundësish të hahen ushqime të shëndetshme).
- Pijet dhe ushqimi të zgjidhen me mençuri (Piramida e të ushqyerit).
- Gjatë të ushqyerit të shkyçen ekranet dhe S'martohen-at.
- Shujta të përbashkëta.
- Të hahet vetëm në tavolinë, pasi që të ushqyerit nuk është aktivitet anësorë.

Edhe pranë qëllimeve më të mira për një ushqim të shëndetshëm, edhe kënaqësia dhe gjëzimi i të ushqyerit janë pjesë përbërëse! Fëmijët nuk e vlerësojnë ushqimin sipas vlerave shëndetësore. Ata dëshirojnë ta përjetojnë ushqimin me të gjitha shqisat; pamja, shija dhe aroma për fëmijët kanë rëndësi të madhe. Edhe të rinxjtë në radhë të parë nuk dëshirojnë të hanë shëndetshëm – për ata shumë më me rëndësi është fuqia fizike apo mendore, Fines-i, dukja e mirë etj. Pra fëmijët nuk donë «ushqim teorik të shëndetshëm» por një ushqim plot fantazi dhe ndryshime e cila ndonjëherë mund të përmban «Fast Food» apo «Ethno Food» (ushqime të shteteve të huaja). Kujdesuni për atë, që në shtëpi të ketë vazhdimisht fruta të freskëta. Tek copat e prera me apetit të pemëve, edhe fëmija Juaj do e kafshon një flegër. Chips dhe rriskat tjera jo të shëndetshme mund të qojnë deri tek mbi pesha. Pra, më mirë jepini fëmijës Tuaj një mes shujtë të zgjedhur me vete, sesa vetëm para.

[www.sge-ssn.ch](http://www.sge-ssn.ch)

[www.food4teens-wohnen.ch](http://www.food4teens-wohnen.ch)

[www.swissmilk.ch](http://www.swissmilk.ch)

[www.znunibox.ch](http://www.znunibox.ch)

[www.pausenbrot.ch](http://www.pausenbrot.ch)

### Dalja në qytet

Të rinxjtë kanë nevoja, të takohen me bashkëmoshatarët, të krijojnë kontakte jashtë familjare dhe ti testojnë këto. Tregoni interesim për stilin e jetës dhe rrethit të shokëve të fëmijës Tuaj. Si përgjegjës për edukim Ju keni të drejtën dhe obligimin, ta përcaktoni mënyrën e daljes së fëmijës Tuaj në qytet. Përcaktoni vendime të qarta dhe kërkoni që këto të mbahen. Vendosni linja të qarta me trajtim të alkoolit dhe duhanit. Tërhiqja vërejtjen fëmijës Tuaj, që ai mos ta humb nga shikimi pijen e tij (Përzierja e substancave të padëshiruara).

Koha e rekomanuar për kthim në shtëpi	11 – 12 Vjeç	13 – 14 Vjeç	15 Vjeç	16 – 17 Vjeç
gjatë javës, gjatë vitit shkollorë	Ora 20.00	Ora 20.30	Ora 21.00	Ora 22.00
në fundjavë, gjatë pushimit shkollorë	Ora 21.00	Ora 22.00	Ora 23.00	Marrëveshje të qarta (Obligim lajmërimi!)

Këto kohëra në dimër duhet ti përshtaten errësirës. Jini konsekuent tek përbajtja e kohërave të përcaktuara! Daljet brenda javës për fëmijë me obligime shkollore duhet të mbetet rast i jashtëzakonshëm!

Nëse fëmija Juaj viziton një festë/ndejë, shtroni pyetjet vijuese:

- Kush organizon festën?
- Ku mbahet festa?
- Për këndë është paraparë ky festivitet (Grup mosha)?
- Cili person i rritur mbanë përgjegjësinë?
- Sa zgjatë festa (të dhëna për kohën e kthimit në shtëpi)?
- Si dhe me këndë kthehesh ti në shtëpi?
- Si mund të arrijë?
- Kur do kthehesh në shtëpi?

Mbështetni fëmijën Tuaj atëherë, nëse ai do ta organizon vet një festë, dhe përcaktoni rregulla të qarta dhe të detyrueshme!

- Në mos praninë Tuaj në shtëpi, pa marrëveshje, mos lejoni ndonjë festë në shtëpi Tuaj.
- Merrni përsipër përgjegjësinë dhe sipas moshës edhe mbikëqyrjen për atë festë.

- Mbështeteni fëmijën Tuaj gjatë përpilimit të ftesave.
- Përcaktoni së bashku me fëmijën Tuaj rrethin e të ftuarve.
- Përcaktoni rregulla të qarta mbi trajtimin e alkoolit dhe duhanit.
- Ndaloni të gjitha llojet tjera të drogave.
- Nga fëmija Juaj kërkonit një marrëveshje me fqinjët (Zhurma).
- Paraprakisht merru vesh mbi pastrimin pas festës.
- Definoni rregullat për kthim në shtëpi.
- Kush bënë shamatë, del jashtë.

Ne nuk ju preferojmë lejimin e pjesëmarrjes gjegj. të organizimit, nëse pyetjet apo rregullat e lartë përmendura nuk janë përgjigjur tërësisht apo nuk do përbahen.

### **Mjete kënaqësie dhe varësie**

Ruga deri tek varësia nuk është gjithmonë e njëjtë. Të rinjtë duhet ta mësojnë trajtimin e mjeteve të kënaqësive dhe varësive, për tu gjendur në botën e të rriturve. Faktorët vijues mundon të mbështesin zhvillimin e shëndetshëm:

- Vetëbesimi dhe ndjeshmëria.
- Trajtimi i stresit dhe presionit në grup dhe aftësie për zgjedhje të problemeve.
- Vetëvendosja, mendimi dhe komunikimi kritik.
- Organizim i kënaqshëm i kohës së lirë dhe perspektiva kuptimplota jetësore

Zbatoni funksionin Tuaj si shembull dhe flisni me fëmijën Tuaj mbi rreziqet e konsumit, eventualisht edhe për përvojat vetjake dhe vështirësive me mjete kënaqësie dhe varësie. Tregoni interesim në jetën e fëmijës, nëse ai ka pyetje në lidhje me mjete kënaqësie varësie. Përcaktoni rregulla (të përbashkëta) dhe zbatoni këto. Kryeni debate mbi motivin, fitimin dhe rreziqet e konsumit.

Sipas Ligjit mbi Mbrojtje të Rinisë, shitja dhe jepja e duhanit (gjithashtu Snus, duhan për thithje), verës, birrës dhe verës së mollëve të rinjve nën 16 vjeç, gjegj. pijeve alkoolike, aperitivëve dhe Alcopops të rinjve nën 18 vjeç janë të ndaluara.

Mënyra më e mirë, për ti zbuluar shkaqet e sjelljeve të dukshme, është bisedimi direkt me fëmijën Tuaj mbi hallet e tij. Gjëja e vetme që këtu ndihmon, është dëgjimi me vëmendje dhe besimi i ndërsjellë. Nëse ju vëreni, që fëmija Juaj konsumon alkool, duhan, kanabis apo të ngashme, kërkon konsultime me punëtorët social shkolle, punëtorët social me të rinjtë apo në zyrat kompetente.

Kini kujdes, që edhe konsumi i tepërt i mediave mund të qon deri në varësi.

[www.suchtberatung-ags.ch](http://www.suchtberatung-ags.ch)

### **Seksualiteti**

Fëmijët kanë nevojë për të rritur, të cilët atyre ju përballën me njohje, dashuri dhe vlerësim dhe nga të cilët ata mësojnë trajtimin e kujdeshëm me raste ekstreme. Një vetëdije trupore dhe një sqarim seksualiteti sipas moshës janë bazat për zhvillim të një vetëdije të shëndetshme në lidhje me trajtim të seksualitetit dhe aspekteve të rëndësishme të parandalimit. Kur fëmija Juaj posedon një njohuri të tërësishme mbi trupin e vet dhe posedon një gjuhë për seksualitetin, atij i vjen më lehtë të vëren dhunën dhe të flet mbi të. Përmes mbështetjes së një vetëdije pozitive mbi trupin e tij Ju fëmijës Tuaj i mundësoni, që ai veten ta vlerëson si unik dhe të vlefshëm dhe të jetë krenar me trupin e vet. Një ndjenjë e sigurtë dhe e vetëdijshme mbi trupin e vet ndihmon, që ai ti vëren më qartë lëndimin e rasteve ekstreme dhe të mbrohet kundër tyre.

- Fëmija Juaj duhet të bëjë dallim në mes të prekjeve të mira/këndshme dhe këqija/pakëndshme.
- Fëmija Juaj duhet të di, që ai guxon të thotë edhe „jo”.
- Fëmija Juaj duhet të bënë dallime në mes të fshehtësive të mira dhe të këqija.
- Fëmija Juaj duhet të di, që trupi i tij i takon vetëm atij.
- Fëmija Juaj duhet të di, se ku ai mund të gjen ndihmë.

Në Zvicër mosha e mbrojtur (përgjegjësia seksuale) është deri në moshën 16 vjeçare. Nën këtë kufi marrëdhëniet seksuale janë të lejuara kur ato kryhen me marrëveshje të ndërsjellë dhe diferenca e moshës në mes pjesëmarrësve nuk është më e lartë se 3 vjet. Marrëdhëniet seksuale janë të ndaluara, kur një person i moshës nën 18 vjeçare ndaj një të rrituri qëndron në një marrëdhënie varësie, do të thotë kur ky person është nxënësi/ja i/e tij/saj, shegert/shegertë apo i /e punësuar.

[www.lilli.ch](http://www.lilli.ch)  
[www.lustundfrust.ch](http://www.lustundfrust.ch)  
[www.pinkcross.ch](http://www.pinkcross.ch)

## E Drejta Penale për Rini

### Ligji për Rini

Për të rinjtë në mes 10 dhe 18 vjeçarë vlen një e drejtë speciale penale – e Drejta Penale për Rini. E Drejta Penale për Rini përbëhet prej Ligjit për Rini (JStG) dhe Kodi Penal për Rini (JStPO). Fëmijët bajnë përgjegjësi penale prej moshës 10.

Përgjegjësia penale tregon atë moshë, prej të cilës dikush për shkak të veprës penale, të cilën ligji e kanos me dënim, mund të dënohet. Përgjegjësia penale në Zvicër fillon prej momentit të mnbushjes 10 vjet. Me këtë, fëmijët më të ri nuk bajnë përgjegjësi penale. Se ado të ket reaksione ndaj veprës penale të një fëmije në moshën 10 vjeçare, shtrihet në kompetenca të prindërve. Në rast të dhënë, enti për mbrojtje të fëmijëve mund të erdhron massa për mbrojtjen e fëmijës.

### Interneti nuk është hapësirë pa ligjshmëri

Registerimi, prodhimi apo distribuimi i përbajtjeve me pornografi apo dhunë të ashpër në një telefon mobil apo PC është i dënueshëm. Edhe shpërndarja e porongrafisë së lehtë tek të rinjtë nën 16 vjeç është e ndaluar. Pajisjet e përdorura për këtë do sekuestrohen dhe do të dorëzohen tek prokurori për rini.

### Edukimi vjen para dënimit

Tek e Drejta zvicerane Penale për Rini në radhë të parë bëhet fjalë për mbrojtje dhe edukim të rinisë. Për këtë arsyе shpes në këtë kuptim ata nuk dënohen, porse atyre ju urdhërohen masa edukative dhe/apo terapeutike.

[www.projuventute.ch](http://www.projuventute.ch)  
[www.tschau.ch](http://www.tschau.ch)  
[www.skppsc.ch](http://www.skppsc.ch)

### Dhe përfund ....

- Lejoni fëmijën Tuaj të mundet të thot edhe „Jo”. Vetëm kështu ai do të mundet gjithashtu të thot „jo” edhe në grup.
- Shikoni me kujdes tek përdorimi i dhunës të çdo lloji dhe reagoni me arsyë sipas situatës.
- Mësoni fëmijën Tuaj të ketë respekt para secilit. Kështu temat si Mobbing, emisioni i zhurmave, Littering, rregullat e mirrësjelljes do të janë probleme të vogla.
- Në biseda familjare tematizoni temat tabu si vetëvrasja, plaçkitje dhe dhuna. Ofroni fëmijës Tuaj mbështetje dhe drejtoni atë kah zyrat kompetente ([www.147.ch](http://www.147.ch), Tel. 147).
- Një organizim i mirë dhe kuptimplotë i kohës së lirë (p.sh. Klubet) mbështet miqësitë dhe ofron një rrëthinë të rëndësishme sociale mësimi ([www.sins.ch](http://www.sins.ch) / Kultur / Freizeit / Vereine)!
- Ritualet e përditshmërisë jepin siguri (p.sh. vaktet e përbashkëta, këshilli familjar, rishikimi i ditës etj.)
- Na ndihmoni, që rinia jonë kohën e lirë të tyre ta shfrytëzon me kuptim dhe në përputhje me moshën e tyre.

## **Parandalimi fillon në shtëpi!**

### **Zyrat e specializuara**

Elternnotruf Aargau  
Tel. 0848 35 45 55  
[www.elternnotruf.ch](http://www.elternnotruf.ch)

Kindernotruf  
Tel. 147  
[www.147.ch](http://www.147.ch)

Regionale Schulsozialarbeit Sins  
Kinder-, Jugend- und Elternberatung  
Tel. 041 789 65 80  
[www.schulesins.ch](http://www.schulesins.ch)

Gesundheitsportal für  
die ausländische Bevölkerung  
[www.migesplus.ch](http://www.migesplus.ch)

Schulpsychologischer Dienst Wohlen  
Tel. 062 832 65 70

Soziale Dienste  
Tel. 041 789 70 10  
[www.sins.ch](http://www.sins.ch)

Jugendarbeit Sins  
Tel. 079 620 40 98  
[www.jugendsins.ch](http://www.jugendsins.ch)

Jugend-, Ehe- und Familienberatung Muri  
Tel. 056 664 37 69  
[www.jefb.ch](http://www.jefb.ch)

Regionalpolizei Muri  
Aussenstelle Sins  
Tel. 056 675 52 75  
[www.muri.ch](http://www.muri.ch)

Migration / Integration in 13 Sprachen  
[www.hallo-aargau.ch](http://www.hallo-aargau.ch)

Berufsberatung / ask  
Tel. 062 832 65 70  
[www.beratungsdienste-aargau.ch](http://www.beratungsdienste-aargau.ch)